


1829/26 28-04-2026



Në bazë të neneve 11 dhe 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 40 paragrafi 2 pika j) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e RK-së” nr.28/2008), nenit 6 paragrafët 2.1. dhe 6, nenit 7 të Ligjit nr.04/L-010 për bashkëpunimin ndërkomunal (“Gazeta zyrtare e RK-së” nr.7/2011), si dhe nenit 13 pika i) të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 të datës 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e dytë të jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 28.04.2026, merr këtë:

**VENDIM NR.20/2026/KG**  
**për miratimin e nismës për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal**

**Neni 1**

Me këtë vendim miratohet nisma e kryetarit të komunës për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal midis Komunës së Graçanicës dhe Komunës së Zubin Potokut.

**Neni 2**

Qëllimi i vendosjes së bashkëpunimit ndërkomunal sipas këtij Vendimi është bashkëpunimi në fushat e menaxhimit të burimeve njerëzore, menaxhimit financiar, funksionimit dhe procedurës së zbatimit të prokurimit publik.

**Neni 3**

Kryetari i Komunës së Graçanicës, me një vendim të veçantë të Kuvendit të komunës, do të autorizohet për fillimin e konsultimeve me komunën e lartpërmendur dhe përgatitjen e propozimit të marrëveshjes për bashkëpunimin e ndërsjellë.

**Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas dorëzimit tek autoriteti mbikëqyrës në kuptimin e nenit 8 lidhur me nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.


  
**Kryesuesi i Kuvendit**  
  
**Milan Dimitrijević**